



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet blerja e një dhurate në vlerë deri në 99.00 (nëntëdhjetë e nëntë euro) për punëtorë shëndetësorë dhe të arsimit në institucionet publike të komunës me rastin e pensionimit (arritjes së moshës së pensionimit).
2. Pagesa në shumën e cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxhetet e Drejtorive përkatëse.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
- Drejtorisë për Arsim
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë